

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 2, datë 9.6.2026

PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 19.7.2022, “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR KRYERJEN E SHËRBIMIT TË PËRKTHIMIT ZYRTAR DHE INTERPRETIMIT TË GJUHËS SË SHENJAVE DHE RREGULLAVE PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E TARIFAVE PËR KATEGORI TË PERSONAVE PËRFITUES TË NDIHMËS JURIDIKE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 8, datë 19.7.2022, “Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike”, bëhet shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në kreun II, pika 6, ndryshohet si më poshtë:

“6. Tarifa e shërbimit të përkthimit me gojë është 4200 (katër mijë e dyqind) lekë për çdo orë përkthimi, pa përfshirë TVSH. Kur ora e fundit e filluar zgjat më shumë se 30 minuta ajo përlllogaritet si orë e plotë, përndryshe tarifa e përkthimit përlllogaritet sa gjysma e tarifës për një orë të plotë. Kur ofrimi i shërbimit të përkthimit bëhet i pamundur për arsye, për të cilat nuk mban përgjegjësi përkthyesi, ai paguhet për një orë të plotë.”.

2. Në kreun II, pas pikës 6, shtohet pika 7, me përmbajtje si vijon:

“7. Për kohën e domosdoshme të udhëtimit nga vendbanimi i tij deri në vendin e ofrimit të shërbimit të përkthimit dhe kohën e kthimit, si dhe për kohën e pritjes përkthyesi paguhet me 1.000 (një mijë) lekë, për çdo orë. Fjalja e dytë e pikës 6, zbatohet edhe për kohën e udhëtimit dhe të pritjes.”.

3. Në kreun III, pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Tarifa e shërbimit të interpretimit të gjuhës së shenjave për një kohëzgjatje prej një ore është 4200 (katër mijë e dyqind) lekë për çdo orë përkthimi, pa përfshirë TVSH lekë. Pikat 6 dhe 7, të kreut II, zbatohen respektivisht.”.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, përkthyesit zyrtarë dhe interpretët e gjuhës së shenjave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Toni Gogu

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj